



**THIRRJE PËR PJESËMARRJE NË SIMPOZIUMIN SHKENCOR  
“LLAZAR (ZAI) FUNDO- FIGURË E SHQUAR E MENDIMIT SHQIPTAR DHE EVROPIAN”**

✚ Në kuadër të Javës së Evropës, Universiteti “Fan S. Noli”, në bashkëpunim me Këshillin e Qarkut Korçë dhe me mbështetjen e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë,

organizon

Simpozimin Shkencor

**“LLAZAR (ZAI) FUNDO- FIGURË E SHQUAR E MENDIMIT SHQIPTAR DHE EVROPIAN”**

✚ Ky simpozium ka për qëllim të ofrojë një analizë të hollësishme të figurës së Llazar Fundos, si një mendimtar kritik dhe një intelektual shumëdimensional që sfidoi ideologjitë e kohës, duke evokuar rolin dhe kontributin e tij në zhvillimin e mendimit shqiptar dhe të ndikimit që pati ky zhvillim në kontekstin evropian. Mirëpresim studiuesit, akademikët, studentët, si dhe profesionistët e fushës të ndihmojnë në promovimin e studimeve dhe të kërkimeve për këtë figurë historike, si dhe në thellimin e diskutimeve dhe të debatit intelektual, për rritjen e ndërgjegjësimit publik, si dhe në drejtim të ruajtjes së memories për trashëgiminë tonë historike.

**Data të rëndësishme:**

✚ Afati i fundit për dorëzimin e abstrakteve: **15 mars 2025**

✚ Njoftimi i pranimit të punimeve: **15 prill 2025**

✚ Dorëzimi i artikujve të plotë për botim: **30 qershor 2025**

✚ Data e organizimit të Seminarit: **16 maj 2025**

✚ Abstraktet dhe punimet e plota të dërgohen në adresën elektronike: **[simpozium.zaifundo@unkorce.edu.al](mailto:simpozium.zaifundo@unkorce.edu.al)**

✚ Për udhëzime mbi formatin e abstraktit dhe të punimeve referojuni hapësirës: **Formati i artikullit për publikim.**

## **Temat e simpoziumit shkencor përfshijnë fushat si vijojnë:**

- ***Llazar Fundo dhe vendi i tij në historiografinë shqiptare***
  - Pozicioni i tij në raport me zhvillimet historike të kohës në Shqipëri;
  - Përndjekja dhe vdekja e tij si simbol i përplasjes së ideve të kohës;
  - Evokimi i figurës së tij në historiografinë shqiptare.
- ***Mendimi politik dhe filozofik i Llazar Fundos***
  - Interpretimi modern i ideve të tij politike dhe filozofike;
  - Rëndësia e tij për zhvillimin e demokracisë dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri dhe në Evropë;
  - Roli i tij në lëvizjet politike të kohës;
  - Qasja e tij ndaj komunizmit dhe ndaj demokracisë;
  - Marrëdhënie e tij me figurat e tjera politike shqiptare dhe ndërkombëtare.
- ***Publicistika e Llazar Fundos***
  - Kontributi i Llazar Fundos si publicist dhe roli i tij në shtypin shqiptar dhe në atë evropian;
  - Kritika e Llazar Fundos ndaj komunizmit dhe totalitarizmit;
  - Vizioni i Llazar Fundos për demokracinë dhe për shoqërinë e hapur;
  - Trashëgimia publicistike e Llazar Fundos dhe rëndësia e saj në ditët tona.

### **Bordi Shkencor i Simpoziumit:**

- Prof. dr. Lorenc Ekonomi, Universiteti “Fan S. Noli”
- Dr. Erjon Nexhipi, Këshilli i Qarkut Korçë
- Dr. Aida Mosko, Universiteti “Fan S. Noli”
- Prof. dr. Gjergji Pendavinji, Universiteti “Fan S. Noli”
- Prof. as. dr. Jonela Spaho, Universiteti “Fan S. Noli”
- Prof. as. dr. Rafail Prodani, Universiteti “Fan S. Noli”
- Prof. as. dr. Edlira Menkshi, Universiteti “Fan S. Noli”
- Dr. Suela Dinellari, Universiteti “Fan S. Noli”

### **Komisioni Organizues:**

- Msc. Eftiona Bylykbashi, Specialiste e Zyrës së Botimeve

### **Vendi ku do të zhvillohet konferenca:**

Universiteti “Fan S. Noli”

Adresa: Shëtitorja “Rilindasit”, 7001, Korçë, Shqipëri

### **Mundësitë e publikimit**

Vetëm autorët që do të marrin pjesë me punimet e tyre do të kenë mundësinë ta botojnë artikullin e tyre në përmbledhjen e posaçme që do të përgatitet me këto punime.

Punimet e dorëzuara do të pranohen për t'u botuar vetëm pasi të kalojnë procesin e vlerësimit nga ekspertët përkatës.

Punimet e përzgjedhura për botim, pas procesit të recensave, do të publikohen në një botim të posaçëm, i pajisur me ISBN, në dy variante (Hard copy dhe Electronic copy), si dhe do të publikohet online në faqen elektronike zyrtare të Universitetit "Fan S. Noli"

### **Formati i artikullit për publikim:**

#### **Titulli i punimit (shqip-anglisht):**

**Autori/ autorët:**

**Adresa e e-mail-it**

**Përmbledhja/ Abstrakti (shqip-anglisht):**

**Fjalët kyçe (shqip-anglisht):**

**Përfundime:**

**Referenca:**

#### **Titulli:**

Titulli i punimit duhet të jetë i shkurtër, i qartë dhe informues (CAPITAL letters font 14, bold). Titulli, emri/at i/e autorit/ëve, Universiteti nga vijnë, si dhe adresat e tyre të e-maile-ve duhet të vendosen në qendër të faqes së punës.

#### **Përmbledhja/ Abstrakti:**

Përmbledhja duhet të dorëzohet në **gjuhën shqipe dhe në atë angleze** (deri në 250 fjalë; 11 pt Times New Roman, line spacing 1)

**Fjalët kyçe:** 5-7 fjalë të renditura alfabetikisht (11pt Times New Roman, Normal)

**Artikulli duhet të shkruhet në** Microsoft® Office Word 2007. Font: 12 pt Times New Roman, single line (justified), line spacing 1, deri në 6 faqe, format A4.

**Citimet brenda tekstit duhet t'i referohen modelit APA:**

<https://www.citationmachine.net/apa>

**Formati i bibliografisë:** <https://www.citationmachine.net/apa>

